

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS -Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Ragip Namani e Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses “S.V.” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit për shqiptimin e gjobës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1075/2014, të datës 14.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.04.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses “S.V.” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1075/2014, i datës 14.12.2016, vërtetohet.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1075/2014, të datës 14.12.2016, është refuzuar kërkesëpapia e paditëses “S.V.” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë, me nr. 597/14 i datës 24.06.2014 si dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar paditësja “S.V.” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, përmes pronarit M.R., për shkak të: shkeljes së dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të anulohet aktgjykimi i atakuar, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, apo, aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpapia e paditësit të aprovohet në tersi, ashtu që paditësja të lirohet nga detyrimi i pagesës së gjobës në shumë prej 300 €, për gjoja kryerje të kundërvajtjes sipas dispozitës së nenit 47 par.2.1 të Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë në Kosovë.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar, nr.597/2014 të datës 24.06.2014 të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Prishtinë, i është refuzuar ankesa me nr.475/14 e datës 19.05.2014 subjektit afarist “S.V.” Sh.p.k, e përfaqësuar nga A.Sh.Drejtor.

Ndërsa mbetet në fuqi vendimi nr. 488 i datës 04.04.2014 i nxjerr nga Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimeve Private të Sigurisë lidhur me shqiptimin e gjobës në shumë prej treqind (300) euro, për shkak të kundërvajtjes se kryer sipas nenit 47 par.2.1 të Ligjit nr.04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë në Kosovë.

Paditësja e pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses e paraqitur kundër vendimit të paditurës nr.597/2014 të datës 24.06.2014 në seancën e shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, padinë e paditëses e refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar duke u bazuar në provave e administruara, si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Andaj, duke u bazuar në provat e administruara, gjykata e shkallës së parë, vendosi që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Me arsyetim se gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur i ka shqiptuar gjobën paditëses. Sepse nuk është kontestuese se me procesverbalin e datës 20.03.2014, të lëshuar nga e paditura, pas riinspektimit tek paditësja, është konstatuar se nuk ka bërë eliminimin e parregullsive të konstatuara me procesverbalin e datës 22.10.2013, për formimin e kompanisë apo angazhimin tek ndonjë kompani e cila është e licencuar. Me ç’rast ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë në Kosovë, përkatësisht nenit 14.2 dhe për të cilën shkelje konform nenit 47 par.2.1 i është shqiptuar gjoba me të holla.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës ka konstatuar se padia e paditëses është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA, ky pretendim nuk qëndron, me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së. Pretendimet ankimore të paditëses nga bazat ankimore ky kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe vlerëson se nuk janë të bazuara, sepse nuk argumentohet se aktgjykimi i goditur është i përfshirë me shkelje të dispozitave ligjore procedurale nga neni 182 par.1 dhe 182 par.2 pika n) të LPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar përmban arsyet e plota dhe të çarta lidhur me faktet vendimtare të përmbledhura si në arsyetimin e tij.

Ndërsa sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses janë të pabazuara, ngase të njëjtat janë

në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës, është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, së nuk është kontestuese së paditësja ka ushtruar veprimtarin e sigurisë privatë pa licencë dhe se i është dhënë afat për eliminimin e parregullsive prej 30 ditëve pune.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjen se gjykata e shkallës së parë, nga dëshmitë e nxjerra ka konstatuar se organi i paditur, ka vepruar drejt kur i ka shqiptuar gjobën paditëses, ngase paditësja nuk ka arritur që të paraqes fakte dhe prova tjera shtesë që dëshmojnë se e paditura ka aplikuar gabimisht dispozitat e nenit 47 par.2.1 të Ligjit nr.04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë në Kosovë. Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt, kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit nr.04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë në Kosovë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses. Pretendimet ankimore në ankesë se aktgjykimi ka tipare të aktgjykimit diskriminues, përkufizuar me dispozitën e neneve 1, 2, 3 dhe 8 të Ligjit nr. 2004/3 kundër Diskriminimit në Republikën e Kosovës, se nuk është në dijeni që bizneseve tjera private “simotra” në territorin e Republikës së Kosovës, iu janë shqiptuar dënime të këtilla me gjobë për gjoja për kundërvajtjeje të kësaj natyre, ky kolegji nuk i aprovoi ngase vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa. Ndërsa pretendimet tjera ankimore nuk mund të qojnë në ndonjë vendim tjetër, dhe janë pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga organi i paditur dhe nga gjykata e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses dhe lënies në fuqi të vendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet ankimore një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AA.nr.41/2017, me datë 11.04.2017

Kryetari i kolegjit,  
Ramiz Kuqi